

## **SI ME IA NISUR NJË BIZNESI (ME HAPUR NJË SHOQËRI TREGTARE) ?**

Sipas rregullave zvicerane të lirive tregtare, nuk është aq vështirë me filluar ndonjë biznes (apo me hapur ndonjë shoqëri tregtare). Vetëm profesionet e ashtuquajtura të « mbrojtura » gëzojnë një status të posaçëm dhe nuk mundet me i ushtruar gjithkushi. Është fjala posaçërisht për profesionet që kërkojnë ndonjë liçencë specifike shtetërore (si janë për shembull, profesioni i mjekut, inxhinierit, e shumë të tjera). Për këtë, konfederata mbanë një listë zyrtare publike.

Për bizneset e shumta që ushtrohen për shembull në sektorë të ndryshëm të ndërtimitarisë, hapjen e ndonjë kafeneje/restorani, etj, **nuk kërkohet ndonjë diplomë specifike apo shkollim**. Mirëpo, nënkuptohet se personat që iu nisen aktiviteteve të tilla kanë shpesh ndonjë përvojë të gjatë profesionale (edhe pse jo çdo herë !).

**Është me rëndësi** që para se të inicohet një projekt biznesi, të merren informata të duhura për të drejtën e ushtrimit të tijë, për kushtet, dokumentet e nevojshme, procedurën e hapjes dhe për të gjitha formalitete e kërkuara sipas ligjit.

**Format më të përhapura** të shoqërive tregtare në Zvicër janë këto si vijojnë:

- Ndërmarrja individuale
- Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar SHPK (SARL – GMBH)
- Shoqëria anonime SHA (SA – AG)

Që të gjitha format mund të krijohen vetëm nga një person. Nuk kërkohet pra dy apo më tepër persona. **Duhet patur kujdesë në ate se format e përmendura nuk i përshtaten çdo lloji aktiviteti tregtar**. Kështu që duhet zgjedhur formën e duhur, n'varsisht nga projekti i biznesit që dëshirojmë t'a realizojmë.

Ekzistojnë disa aktivitete kur dikushi dëshiron të ushtrojë vetë ndonjë biznes, i cili në mes tjerash nuk karakterizohet me ndonjë rrezik të lartë financiar, atëherë konkretizimi i projektit të tillë mund të realizohet përmes ndërmarjes individuale. Është kjo forma më pak e koklavitur.

Ndërsa, për bizneset kur dikushi i futet ndonjë aktiviteti me dikend tjetër (ortak), atëherë ekzistojnë më tepër përparësi që të kalohet përmes SHPK. Shpesh është e këshillueshme kjo formë. Shoqëritë anonime natyrisht se këshillohen në rastet e fillimit të ndonjë biznesi me një dimension përgjegjësie shumë të lartë se sa format tjera.

**Përparësi më e madhe e SHPK** lidhet me faktin se në rast të humbjeve apo edhe të dëmeve të shkaktuara ndaj personave të tretë, përgjegjësia për borxhet bartet kryesisht tek kapitali ekzistues i SHPK (e jo tek kapitali personal i udhëheqësit të SHPK, për shembull). Kështu që ortakët që i futen këtij biznesi janë të mbrojtur më mirë, edhe ate në përputhje me shumën e kapitalit të investuar.

Ajo që i jepë një status të njohur shoqërive të ndryshme tregtare është **regjistrimi në regjistrin tregtar** (registre du commerce - handelsregister). N'varsisht nga forma juridike e biznesit të zgjedhur, regjistrimi nuk është çdo herë i detyrueshëm. Ekzistojnë kriterë precizë për këtë. Edhe rregullat për sigurimin e shoqërive tregtare, pagesat e tatimeve, të TVSH, dhe shumë detyrimeve të tjera, dallojnë n'varësiht nga forma e zgjedhur e biznesit.

Forma më e përhapur e ndërmarreve tregtare mbetet SHPK. Kapitali minimal që duhet investuar është Fr. 20'000.--. Mbi 92000 SHPK janë të regjistruara aktualisht në Zvicër. Fatëkeqësisht, është pikërisht

edhe kjo formë, ajo e cila hapë disa herë edhe rrugën më të lehtë të keqpërdorimeve, pasi që përgjegjësia individuale mundë të bartet lehtë në adresë të shoqërisë tregtare. Tepër e më tepër, gjendemi edhe përballë fenomenit të SHPK fiktive (të hapura me qëllime dredhrrash apo të largimit nga pagesa e tatimeve, etj). Statistikat tregojnë se numri i tyre është shtuar më së tepërmi sidomos pas hapjes së tregut gati se të «pakufizuar» ekonomik edhe ndaj shtetasve që vijnë nga BE.

Neuchâtel, me 27 gusht 2017/LB

Tekst i përgaditur nga

Zyra për këshilla juridike «BEGZATI»  
Av. J. J. Rousseau 7, 2000 Neuchâtel  
[www.zyra-begzati.ch](http://www.zyra-begzati.ch)